



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE
Agjencia e Prokurimit Publik

Adresa: Bulevardi "Dëshmorët e Kombit", Keshilli i Ministrave, Tel & Fax: 04230434

U D H Ë Z I M Nr.2, datë

18.02.2008

PËR PROCEDURËN E PROKURIMIT ME VLERA TË VOGLA

Agjencia e Prokurimit Publik, në mbështetje të nenit 13 të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik", (i ndryshuar)dhe pikës 2/d të Kapitullit VI të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.1, datë.10.01.2007 "Rregullat e Prokurimit Publik",

Udhëzon:

1. Autoriteti kontraktor mund të përdorë procedurën e prokurimit me vlerë të vogël për mallra, shërbime dhe punë, vlera e të cilave gjatë vitit buxhetor nuk duhet të jetë më e madhe se 400.000 (katërqindmijë) lekë. Në këtë vlerë nuk përfshihet TVSH-ja.

2. Titullari i autoritetit kontraktor ose personi i autorizuar prej tij në fillim të çdo viti kalendarik ngre komisionin e prokurimit me vlerë të vogël ose në rast mungese personeli, autorizon Njësinë e Prokurimit për realizimin e këtyre procedurave te prokurimit.

Komisioni përbëhet nga 3 anëtarë, njëri prej të cilëve është kryetar, sipas formularit nr.1 bashkëlidhur.

3. Kjo lloj procedure do të përdoret për blerjen e një grupi mallrash kryerjen e shërbimeve apo puneve të ngjashme që kanë të njëjtin funksion kryesor apo që kanë të njëjtin emërtim në planin e shpenzimeve dhe nuk duhet parë si mundësi për shmangien e procedurave normale të prokurimit, duke prokuruar në këtë formë dhe brenda kësaj vlere, të ndarë nga njëri tjetri, mallra apo shërbime që përfshihen në një grup për shkak të ngjashmërisë së tyre apo për shkak të funksionit kryesor.

4. Autoriteti kontraktor planifikon që në fillim të vitit buxhetor natyrën, sasinë dhe llojet e mallrave, shërbimeve dhe zërat e punëve që do të prokurohen në këtë mënyrë.

Në asnjë rast autoriteti kontraktor, nuk është i detyruar të prokurojë njëherësh të gjithë sasinë e mallrave, shërbimeve apo të punëve për plotësimin e nevojave.

Autoriteti kontraktor mund të realizojë disa procedura blerje me vlerë të vogël gjatë vitit kalendarik në varësi të nevojave dhe mundësive të tij, por shuma e këtyre procedurave për të njëjtin mall, shërbim ose grup mallrash nuk duhet të jetë më e madhe se 400.000 (katërqindmijë) lekë në vit.

5. Titullari i autoritetit kontraktor ose personi i autorizuar prej tij nxjerr urdhrin e prokurimit ku përcaktohet natyra dhe sasia e mallrave, shërbimeve dhe punëve, të cilat kërkohen të prokurohen në këtë procedurë, sipas formularit nr.2 bashkëlidhur. Anëtarët e komisionit të prokurimit me vlera të vogla testojnë tregun për të marrë tregues për çmimet e punëve, mallrave ose të shërbimeve, të cilat i pasqyrojnë në një proces-verbal të mbajtur dhe të nënshkruar nga të tre anëtarët sipas formularit nr. 3 bashkëngjitur. Bazuar në kriterin e çmimit më të ulët, komisioni përcakton fituesin. Anëtarët e komisionit i drejtohen operatorit ekonomik, që ka ofruar çmimin më të ulët dhe bëjnë blerjen e mallrave, kryerjen e punëve ose të shërbimeve. Gjatë të gjithë procedurës duhet të mbahet proces-verbal, sipas formularit nr.4 bashkëlidhur, i cili nënshkruhet nga të gjithë zyrtarët e përfshirë në proces, duke i bashkëlidhur faturat përkatëse.

6. Procedura e prokurimit me vlerë të vogël, mund të përdoret për blerjen e mallrave, apo kryerjen e shërbimeve të paparashikueshme me vlerë jo më të madhe se 400.000 (katërqindmijë) lekë. Në të tilla raste emergjence dhe ku prania e komisionit është e pamundur, prokurimi do kryhet në vend pa u respektuar procedura e mësipërme, në prani të personave (përfaqësues të institucionit) që ndodhen në vend dhe që mbajnë një procesverbal midis tyre për ngjarjen e ndodhur. Mënyra e pagesës kur përdoret prokurimi me vlerë të vogël në rastet e emergjencës do të bëhet sipas legjislacionit në fuqi. Në çdo rast, faturat e mallrave, shërbimeve apo punëve duhet të jenë të rregullta, në përputhje me legjislacionin në fuqi, dhe duhet të nënshkruhen nga të gjithë personat (përfaqësues të institucionit) e pranishëm në vendin e kryerjes së prokurimit. Proces-verbali i mbajtur midis personave të pranishëm së bashku me faturën përkatëse të nënshkruar prej tyre, i dorëzohen Komisionit të prokurimit me vlera të vogla, të cilët mbajnë proces-verbalin, sipas formularit 5 bashkëlidhur, nënshkruajnë faturën dhe të gjithë dokumentacionin dhe ia dërgojnë Zyres së Financës për likuidim.

7. Ky udhëzim shoqërohet me formularët standarte për prokurimin me vlera të vogla.

8. Udhëzimi nr. 1, datë 20.03.2007 “Për blerjet me vlera të vogla”, shfuqizohet.

9. Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë.

DREJTOR

Klodiana CANKJA

(autoriteti kontraktor)

URDHËR

Nr _____ datë _____

PËR

KRIJIMIN E KOMISIONIT TË PROKURIMIT ME

VLERA TË VOGLA

Bazuar në pikën 2/a “Prokurimi me vlerë të vogël”, të Kreut VI “Zhvillimi i procedurës së kërkesës për propozime, prokurimit me vlera të vogla, shërbimet e konsulencës, konkursi i projektimit”, të VKM nr.1 datë 10.01.07 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar),

Urdhëroj:

Të krijohet komisioni për prokurimin me vlera të vogla i përbërë nga:

1. Kryetar
2. Anëtar
3. Anëtar

Ky komision do të funksionojë gjatë gjithë vitit kalendarik _____ .

**TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR/OSE PERSONI I
AUTORIZUAR**

(emri, mbiemri, firma, vula)

(autoriteti kontraktor)

URDHËR PROKURIMI

Nr _____ datë _____

PËR PROKURIMIN ME VLERA TË VOGLA

Mbështetur në nenin 29, pika 5, të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, (i ndryshuar), pikën 2/a “Prokurimi me vlerë të vogël”, të Kreut VI “Zhvillimi i procedurës së kërkesës për propozime, prokurimit me vlera të vogla, shërbimet e konsulencës, konkursi i projektimit”, të VKM nr.1 datë 10.01.07 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar), për nevojat e _____ , të përdoret procedura e prokurimit me vlera të vogla për sa më poshtë:

1. _____ (mall/shërbim/punë) _____ (sasia dhe njësia)
 2. _____ (mall/shërbim/punë) _____ (sasia dhe njësia)
 3. _____ (mall/shërbim/punë) _____ (sasia dhe njësia)
- Etj. _____ (mall/shërbim/punë) _____ (sasia dhe njësia)

**TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR /OSE PERSONI I
AUTORIZUAR PREJ TIJ**

(emri, mbiemri, firma, vula)

autoriteti kontraktor

PROCES-VERBAL

I mbajtur sot me datë _____ në _____
(data) (autoriteti kontraktor)

nga komisioni i prokurimit me vlera të vogla, i krijuar

me urdhërin e brendshëm nr. _____ dt. _____, në zbatim të
(nr. i urdhrit) (dt. e urdhrit)

urdhrit të prokurimit nr. _____ dt. _____ për prokurimin si
më poshtë: (nr. i urdhrit) (dt. e urdhrit)

1. _____
(mall/shërbim/punë) (sasia dhe njësia)

2. _____
(mall/shërbim/punë) (sasia dhe njësia)

3. _____
(mall/shërbim/punë) (sasia dhe njësia)

4.etj. _____

Komisioni i prokurimit me vlera të vogla pasi testoi tregun mori treguesit për çmimet e blerjeve/shërbimeve dhe punëve të cilat janë objekt i urdhërit të prokurimit, konkretisht si më poshtë:

1. _____
(emri i operatorit ekonomik)

(Mall/shërbim/punë) (sasia, njësia) (cmimi) (Vlera)

2. _____
(emri, i operatorit ekonomik)

(Mall/shërbim/punë) (sasia, njësia) (cmimi) (Vlera)

3. _____
(emri, i operatorit ekonomik)

(Mall/shërbim/punë) (sasia, njësia) (cmimi) (Vlera)

4. _____
(emri, i operatorit ekonomik)

(Mall/sherbim/pune) (sasia, njesia) (cmimi) (Vlera)

Etj.

KOMISIONI

1. _____ Kryetari
(emri, mbiemri, firma)

2. _____ Anëtar
(emri, mbiemri, firma)

3. _____ Anëtar

(emri, mbiemri, firma)

(autoriteti kontraktor)

PROCESVERBAL

I mbajtur sot me datë _____ , në _____
(autoriteti kontraktor) nga komisioni
i prokurimit me vlera të vogla i krijuar me urdhërin e
brendshëm nr. _____ , dt. _____ , në zbatim të urdhrin të prokurimit nr.
_____ dt. _____ si dhe procesverbalit të mbajtur në datë _____ ,
mbahet ky procesverbal për aprovimin e çmimeve të paraqitura nga komisioni, për
mallrat, shërbimet apo punët e mëposhtme:

1. _____
(mall/shërbim/punë) (sasia dhe njësia)

Etj. _____
(mall/shërbim/punë) (sasia dhe njësia)

Komisioni i prokurimit me vlera të vogla, pasi shqyrtoi treguesit e çmimeve të
paraqitura, në procesverbalin sipas formularit nr.3, bazuar në kriterin e çmimit më
të ulët, vendosi të përcaktojë si fitues

_____ me këtë
(emri i operatorit ekonomik)

tregues çmimi:

(mall/shërbim/punë) (sasia dhe njësia) (çmimi) (vlera)

Ngarkohen për kryerjen e veprimeve të mëtejshme me operatorin ekonomik të
miratuar në këtë procesverbal, anëtarët e komisionit si më poshtë:

1. _____
(emri, mbiemri)

2. _____
(emri, mbiemri)

KOMISIONI

1. _____ Kryetari
(emri, mbiemri, firma)

2. _____ Anëtar
(emri, mbiemri, firma)

3. _____ Anëtar
(emri, mbiemri, firma)

(autoriteti kontraktor)

PROCESVERBAL

I mbajtur sot me datë _____ në _____
(data) (autoriteti kontraktor)

nga komisioni i prokurimit me vlera të vogla, i krijuar me

urdhërin e brendshëm nr. _____ dt. _____ , për aprovimin e
(nr. i urdhrit) (dt. e urdhrit)

çmimit të paguar nga _____ për _____
(emri i personit që ka kryer pagesën)

_____ me faturën nr. _____
(malli ose shërbimi) (numri i faturës)

dt. _____ , lëshuar nga _____ .
(data e faturës) (njësia e shitjes ose servisit)

Nevoja për _____ ndodhi me datë _____
(mallin ose shërbimin) (data)

Në _____
(vendi dhe rrethanat e ngjarjes)

Kjo ngjarje nuk mund të parashikohej dhe urgjenca e _____
(mallit ose shërbimit) nuk lejonte
mbledhjen e komisionit të prokurimit me vlera të vogla për të miratuar paraprakisht çmimin e faturës.

KOMISIONI

1. _____ Kryetari
(emri, mbiemri, firma)

2. _____ Anëtar
(emri, mbiemri, firma)

3. _____ Anëtar

TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR /PERSONI I AUTORIZUAR

(emri, mbiemri, firma, vula)